



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:059494
Datë: 27.02.2023
Numri i dokumentit: 04019679

A.nr.741/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE, me gjyqtaren Liridona Ajeti Kajtazi, me sekretare juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit Komuna e Glllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit, kundër të paditurës-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Inspektorati i Punës, me palë të interesit A.M., përfaqësuar nga avokat M.S.E, Prishtinë, me bazën juridike: anulim vendimi, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, me datë 22.02.2023 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Komuna e Glllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit, kundër të paditurës- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Inspektorati i Punës.

II. ANULOHET vendimi i të paditurës Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektoratit të Punës (MPMS - IP), Nr.prot.126 datës 09.03.2022 dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Paditësi me padinë e datës 29.03.2022 ka kërkuar anulimin e vendimit datë 09.03.2022.

E paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në përgjigjen në padi, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që padia të refuzohet dhe të mbetet në fuqi vendim i të paditurës.

Në seancën e datës 22.02.2023, palët janë ftuar me ftesa të rregullta, andaj Gjykata ka mbajtur të njëjtën në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me qëllim të vërtetimit të fakteve, gjykata në seancën kryesore publike të datës 22.02.2023, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendim i dt. 09.03.2022, kërkesa e dt.11.09.2019,

aktvendim i dt.12.09.2019, kontratë pune për mësimdhënës e dt.22.10.2019, ankesë e dt.15.10.2020, aktvendim i dt.22.10.2020, kontratë punë për mësimdhënës i dt.01.09.2020, vendim i dt.25.05.2021, ankesë e dt.21.07.2021, diplomë e dt. 22.11.2016, diplomë e baqellor dt.13.06.2013,vërtetim i dt. 29.03.2022.

Me vendimin e të paditurës, data 25.05.2021, aprovohet ankesa e këtu palës me interes me të cilën ankesë ka theksuar se me vendimin e datës 23.11.2020 i është mohuar e drejta në plotësimin e orëve të cilat kanë qenë të lira në SHMP Fehmi Lladrovci, Drenas.

Me vendimin e organit të shkallës së parë nr.126 datë 09.03.2022, refuzohet ankesa e këtu paditësit dhe vërtetohet vendimi i datës 07.09.2020, në të cilin vendim konstatohet se shkalla e parë ka bërë aplikim të drejtë të dispozitës ligjore kur ka konstatuar se punëdhënësi duhet të respektoj kontratën e punës dhe *se në rast të ndryshimit të orëve të lidh kontratë të re.*

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, edhe në kuptim të neni 47 dhe 48 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ligj ky i aplikueshëm në periudhën e ankimimit dhe shqyrtimit të çështjes pran organit administrativ. I njëjti bën një përshkrim të rrjedhës së procedurës, duke vazhduar me arsyetimin mes tjerash se shkalla e parë ka bërë aplikim të drejtë të dispozitës ligjore kur ka konstatuar se punëdhënësi duhet të respektoj kontratën e punës dhe se në rast të ndryshimit të orëve të lidh kontratë të re. Andaj gjykata duke pasur parasysh një arsyetim të tillë konstaton se i njëjti është në kundërshtim me nenin 47 dhe 48 të LPPA, i njëjti nuk arsyeton se cili pretendim i këtu paditësit është jo bindës dhe cilat janë faktet të cilat janë shqyrtuar nga organi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë, me të cilat organi i shkallës së dytë ka konstatuar se organi i shkallës së parë drejtë ka konstatuar gjendjen faktike, drejtë ka aplikuar dispozitat ligjore dhe drejtë ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ka konstatuar se i aprovoi edhe organi i shkallës së dytë. Po ashtu në arsyetimin e vendimit nuk referohen provat të cilat ishin të pa papranueshme për organin e shkallës së dytë dhe arsyen pse ishin të papranishme –jo bindëse dhe mbi të gjitha këto shkelje procedural të sipërcituara arsyetimi i vendimit është në kundërshtim me vërejtjet e Gjykatës të dhëna në aktgjykim A.nr.1776/2019 për të cilat vërejtje e paditura ka qenë e detyruar ti zbatoj në kuptim të nenit 65 të LKA-së.

Gjykata po ashtu iu referua nenit 2 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, i cili përcakton se: “2. *Inspektorati i punës:*

- a) *Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë.*
- b) *Do t’iu siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënësve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore.*
- c) *Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm.*

- d) *Do t'iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t'i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese.*
- e) *Do t'iu jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje”.*

Ndërsa me Ligjin Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, teksti te pika “a” e nenit 2, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet me tekstin “*Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë*”.

Në anën tjetër, neni 79 i Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, përcakton se: *Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.*

Bazuar në këtë, gjykata vlerëson se autoriteti i organeve administrative, në këtë rast i të paditurës Inspektorati i Punës, duhet të shtrihet deri në atë masë sa nuk tejkalon kufijtë e kompetencës të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar tek një institucion tjetër. Andaj dhe ka anuluar vendimet e të paditurës.

Në frymën e këtij konstatimi Gjykata kishte parasysh edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr.ref.AGJ 2098/22 datë 16.12.2022, ku përcaktohet mes tjerash se ajo çfarë i është lejuar Inspektoratit të Punës me nenin 83 të Ligjit të Punës dhe nenit 25 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin është mundësia e zbatimit të masës ndëshkuese (gjoba) në rast të konstatimit të parregullsive nga ana e punëdhënësit, si dhe raportimi i këtyre parregullsive në MPMS ose tek ndonjë autoritet tjetër kompetent. Asnjë normë e ligjit të Punës dhe Ligjit për Inspektoratin e Punës, nuk parasheh apo nënkupton që Inspektoratit të Punës t'i jepet autoritetet me atributet të një “gjykate” apo të një “tribunali të pavarur”. Gjykata konsideron se ne rastin konkret pretendimi për ndërhyrje në kompetenca të gjyqësorit, , nga ana e Inspektoratit te Punës, nuk rezulton te jete shkak i papajtueshmërisë se nenit 94 te Ligjit të Punës me Kushtetutën, gjegjësisht me nenet 3, 24, 31, 49 dhe 54 të Kushtetutës, por rezultat i interpretimit dhe i interpretimit dhe zbatimit te gabuar te nenit 94 të Ligjit të Punës dhe i Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, nga ana e Inspektoratit te Punës. Sipas kuptimit të kësaj dispozite te Kushtetutës, gjykata referuese, por edhe gjykatat e instancave me te ulëta, gëzojnë juridiksion te plote, qe ne situatat kur ato ballafaqohen, qofte me kolizione te ligjeve, me interpretim a zbatim te gabuar ose arbitrar te ligjeve te aplikueshme, me tejkallim te kompetencave te percaktuara me ligj nga ana e një autoriteti publik, apo me çfarëdo veprimi tjetër qe bie ndesh me ligjin, t'i shpallin vendimet dhe veprimet e tyre te jashtëligjshme. Gjyqësorit i është besuar autoriteti i ushtrimit të një funksioni të rëndësishëm shoqëror, ai i zgjidhjes se mosmarrëveshjeve e kontesteve të natyrës juridike, andaj i takon atij që përmes vendimmarrjes gjyqësore ne përputhje me normat e zbatueshme, te përmbush këtë funksion shoqëror.

Me nenin 2 paragrafi 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcaktohet:” *Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*”, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në këtë kuptim Gjkata anuloi vendimin e atakuar dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim të e paditura, duke pasur parasysh se kërkesë tjetër në shqyrtim gjyqësor nuk është parashtruar, andaj bazuar në kërkesën Gjkata vendosi si në dispozitiv. Në këtë drejtim, gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, po ashtu të ketë parasysh nenin 21 të LPPA dhe pasi t’i mënjanoj të metat, të merr aktvendim të drejtë, e të bazuar në ligj, me të cilin do të njoftohen palët me kohë.

Gjkata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5,6, dhe 38 si dhe nenit 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.741/2022, datë 22.02.2023

Sekretare Juridike
Nazife Sheholli

G j y q t a r j a
Liridona Ajeti-Kajtazi

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*